



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 228, datë 29.10.2024

PËR

**CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE “VËREJTJE PUBLIKE” NDAJ MAGJISTRATIT
AGRON BUSHATI, ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*më tej, Këshilli*), bazuar në nenet 148/d, pika 1, 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, shkronja "b", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 102, pika 2, shkronja "dh", 105, 115, 138, 141, 142 dhe 146, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 159, pikat 1, 2, shkronja "b", 161, 189, pika 1, shkronja "a", 190, pikat 1 dhe 2 dhe 192, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Rregulloren "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shqyrtoi Kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor sipas Shkresës nr. 254/41 prot., datë 23.07.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që i përket palëve:

KËRKUES:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani

SUBJEKT I PROCEDIMIT:

Z. Agron Bushati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

OBJEKTI:

-Fillimi i procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. Agron Bushati, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

-Propozimi i masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në një vit”, e parashikuar nga neni 108 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, shqyrtoi çështjen në përputhje me parashikimet e neneve 142 dhe vijues, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*më tej, Ligji për Statusin*) dhe dëgjoi:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë** (*më tej, Inspektorit*), **përfaqësuar nga Inspektor Julian Zonja**, i cili përfundimisht deklaroi, se : i qëndronte kërkesës së paraqitur;
- **Magjistratin Agron Bushati**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i cili përfundimisht kërkoi: rrëzimin e kërkesës së Inspektorit për dhënien e masës disiplinore.

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Inspektori ka filluar hetimin disiplinor mbi bazën e ankesës së shtetasit ***, regjistruar me nr. *** prot., datë ***. Ankuesi i është drejtuar me ankesë edhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ankesë e cila është dërguar për kompetencë pranë Inspektorit. Aty ngrihen pretendime të njëjta, si në ankesën nr. *** prot., datë ***.

2. Ankuesi parashtron se është dënuar me vendim të formës së prerë dhe po vuan dënimin në burgun e ***. Sipas tij, vendimi i dënimit të tij ka marrë formë të prerë që në vitin ***, por ai po kryen dënimin me burgim, si i paraburgosur, si pasojë e mosveprimeve të prokurorit Agron Bushati. Sipas tij, prokurori ka *** vjet që nuk ka dërguar urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal dhe për pasojë, ai po qëndron prej *** vitesh me statusin e të paraburgosurit, duke u kufizuar në të drejtat e tij si i dënuar me burgim. Ankuesi e mbyll me faktin se nuk dëshiron ta shlyejë dënimin prej *** vjetësh me status “të paraburgosuri” dhe kërkon procedimin disiplinor të magjistratit Agron Bushati.

3. Ankuesi i është drejtuar sërish Inspektorit me ankesën nr.*** prot., datë ***, ku ngrihen të njëjtat problematika në lidhje me mosveprimin e magjistratit Agron Bushati. Sipas tij, gjendja e paligjshmërisë vazhdon, pasi ky prokuror ende nuk e ka nxjerrë “urdhrin e ekzekutimit” të vendimit penal dhe, për rrjedhojë, janë shkelur të drejtat e ankuesit. Ai, ndër të tjera shprehet, se:

*“sipas kanunit duhet me i çue pleqt te shpia prokurorit e me e pytë se çfarë borxhi të kam unë dhe vëllai im ***”.*

4. Bazuar në sa më sipër, Inspektori ka marrë vendim për verifikimin e ankesës së ankuesit ***, sa u përket pretendimeve për shkelje disiplinore në lidhje në ushtrimin e funksionit të magjistratit Agron Bushati.

5. Fillimisht, me shkresën nr.*** prot., datë ***, Inspektori i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për marrjen e të dhënave shtesë: *“Kopje të njësuar e Vendimit nr. ***, datë ***, si dhe aktet e njoftimit të këtij vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”*. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është kthyer përgjigje dhe janë vendosur në dispozicion aktet.

6. Me shkresën nr.*** prot., datë ***, Inspektori i është drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër për marrjen e të dhënave shtesë, si: *“Të gjitha vendimet penale të formës së prerë për shtetasin z. *** dhe praktikant e ekzekutimit të tyre, përfshirë kërkesa/memorie të këtij shtetasi për ekzekutimin e vendimit penal”*.

Nga Gjykata e Apelit Shkodër është kthyer përgjigje dhe janë vendosur në dispozicion aktet e kërkuara, ku kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

- Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Vendimin nr. ***, datë ***, ka vendosur:
*“Njohjen e Vendimit penal nr. ***, datë *** të Gjykatës së ***, i cili ka marrë formë të prerë më datë ***, për dënimin e shtetasit shqiptar *** me *** muaj burg dhe *** euro gjobë për veprën penale të parashikuar nga neni 170, 624, 625 n 7, 61, n .5 K.P “Vjedhje në bashkëpunim e kryer më shumë se një herë”.*
*“Njohjen e Vendimit nr.***, datë *** të Gjykatës së Apelit ***, i cili ka marrë formë të prerë më datë ***, me të cilin shtetasi shqiptar *** është dënuar me *** burg dhe *** euro gjobë, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 73 dhe 80 të dekretit 309/1990, nenit 81 cpv, nenit 110 dhe 648 K.P, nenit 2, të Ligjit 895/67, në të cilat parashikohen si vepra penale “Importimi, eksportimi, transportimi, blerja dhe mbajtja me qëllim shitjeje të lëndëve narkotike” e kryer në bashkëpunim, si dhe “Mbajtja në mënyrë të paligjshme e armëve”, në bashkëpunim.*
- Në bazë të urdhrit të ekzekutimit të Prokurorisë së ***, nr. ***, për bashkimin e dënimeve, dënimi përfundimtar, i shtetasit *** të jetë *** burg dhe *** Euro gjobë, si dhe heqja e të drejtës për tu emëruar në një post zyrtar dhe heqja e të drejtës legale gjatë shlyerjes së masës së dënimit.
- Kundër këtij vendimi, më datë ***, ka paraqitur ankim av. ***.
- Gjykata e Apelit Shkodër, bazuar në nenin 420/I shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në Vendimin unifikues nr. 1, datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të

Gjykatës së Lartë, me Vendimin e saj nr. ***, datë *** ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga av. *** kundër Vendimit nr. *** datë ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- Mbi Rekursin e paraqitur nga ***, me Vendimin nr. ***, datë ***, Gjykata e Lartë ka vendosur: *"Prishjen e Vendimit nr. ***, datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues"*.
- Gjykata e Apelit Shkodër me Vendimin tjetër nr.***, datë *** ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë mënyrë:
- *"Njohjen e Vendimit penal nr. ***, datë *** të Gjykatës së ***, Itali dhe dënimit e *** me *** burg, për veprën penale të parashikuar nga neni 624,625 n.7, 61, n.5 K.Penal italian, e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal shqiptar.*
- *"Njohjen e Vendimit penal nr. *** të Gjykatës së Apelit ***, dhe dënimit e *** me *** burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 73 dhe 80 të dekretit 309/1990, nenit 81 cpv, nenit 110 dhe 648 K.P, nenit 2, të Ligjit 895/67, ligji italian dhe të parashikuara nga nenet 278/3 e 283/a/2 të Kodit Penal shqiptar.*
- *Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, *** dënohet përfundimisht me *** vite burgim.*

Nga shqyrtimi i akteve të administruara më sipër, rezulton se në datën ***, shtetasi *** është dënuar përfundimisht me *** vite burgim, në bazë të vendimit të formës së prerë nr. ***, datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

7. Me shkresën nr.*** prot., datë ***, Inspektori i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ka kërkuar: *"Kopje e njësuar e akteve nëpërmjet të cilave kjo gjykatë, i ka komunikuar prokurorit vendimin e dënimit penal nr. *** datë *** të Gjykatës së Apelit Shkodër, në funksion të ekzekutimit të këtij vendimi"*.

Nga të dhënat e paraqitura prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

*"Nga verifikimi i librit të korrespondencës së dërgimit të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pranë Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vitet ***, rezulton, se Vendimi *** datë ***, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shënimet e vendimmarrjes së Vendimit nr.*** datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër është dorëzuar pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Shkodër, me datë ***, provuar kjo nga fleta e rregjistrimit të librit të korrespondencës së cituar më lart, me nr. Rendor ***, marrë në dorëzim nga personi i autorizuar kundrejt nënshkrimit. Gjithashtu, po nga ky libër korrespondence, rezulton se nga ana e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, me datë ***, pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Shkodër është dërguar Vendimi me nr. ***, datë ***, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shënimet e vendimmarrjes së Vendimit nr. *** datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër, provuar kjo nga fleta e rregjistrimit të*

korrespondencës së cituar më lart, me nr. rendor ***, marrë në dorëzim nga personi i autorizuar kundrejt nënshkrimit.

Sa më sipër, ju bëjmë me dije se fashikulli gjyqësor me nr. Vendimi ***, datë ***, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi bazën e rekursit të ushtruar nga i dyshuari ***, ndodhet pranë Gjykatës së Lartë që prej datës ***."

Nga shqyrtimi i informacionit dhe i akteve bashkangjitur rezulton, se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është njoftuar në të dy rastet, që vendimi i njohjes ka marrë formë të prerë, pra, në lidhje me vendimmarjen e Gjykatës së Apelit Shkodër që i përket Vendimit nr. *** ***, datë ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

8. Me shkresën nr.*** prot., datë ***, Inspektori i është drejtuar I.E.V.P. ***, për marrjen e të dhënave, si më poshtë: "Informacion për shtetasin z. ***, mbi statusin e trajtimit të tij në këtë I.E.V.P., si i paraburgosur apo i dënuar, si dhe kopje të Urdhrave të Ekzekutimit të Vendimit Penal në lidhje me këtë shtetas."

Nga të dhënat e paraqitura prej I.E.V.P. *** kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

*"Shtetasi ***, i datëlindjes ***, është arrestuar në datën ***. Me Urdhrin nr. ***, datë *** të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është transferuar nga IEV Penale *** për në IEV Penale *** për arsye rikonstruktimi, në statusin e të paraburgosurit.*

*Me shkresën nr. *** A.B, datë *** është dërguar Urdhër Ekzekutimi në lidhje me ekzekutimin e Vendimit ***, datë ***, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, dhe marrë formë të prerë me Vendimin ***, datë *** të Gjykatës së Apelit Shkodër.*

*Me shkresën nr. ***, datë ***, "Kërkesë për transferim .." të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektorit Ligjor dhe Kartotekës Tiranë është kërkuar transferimi nga seksioni i paraburgimit në IEV Penale *** në seksionin e të dënuarve në një nga IEVP-të, për shkak të marrjes së vendimit të dënimit të formës së prerë, duke kaluar me statusin e të dënuarit.*

*Me Urdhrin nr *** Prot, datë *** të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është urdhëruar transferimi i të burgosurit ***, nga seksioni i paraburgimit në seksionin e të dënuarve në IEVP ***.*

9. Me shkresën nr.*** prot., datë ***, Inspektori i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për marrjen e të dhënave, si më poshtë: "Informacion për shtetasin z. ***, i cili vuan dënimin me burgim pranë IEV Penale ***, në të cilin të pasqyrohet dinamika e vuajtjes së dënimit për këtë shtetas, periudha e dënimit të shlyer nga ky i burgosur sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit, si dhe periudhën e mbetur të dënimit që duhet të shlyejë ky i dënuar".

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

*"Shtetasi ***, i datëlindjes ***, aktualisht po vuan dënimin në IEVP ***, pasi me Vendimin Nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor *** është dënuar me *** vjet burgim, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni/et 134/2, 278/3 të Kodit Penal.*

*Me përlllogaritjet e kryera nga IEVP *** në datën ***, rezulton se nga dënimi i dhënë ndaj tij, ka vuajtur *** burgim. I mbeten për të vuajtur *** burgim.*

*Nga shqyrtimi i dinamikës së vuajtjes së dënimit, vihet re se të dënuarit *** me periudhën e paraburgimit ka përfutur *** ulje dënimi, ndërsa nuk rezulton të ketë përfutur ulje të tjera dënimi (ulje dënimi nëpërmjet vendimit të gjykatës)."*

10. Bazuar në sa më sipër, Inspektori ka vlerësuar se ka vend për fillimin e hetimit disiplinor për veprimtarinë e magjistratit Agron Bushati. Për rrjedhojë, me Vendimin nr. *** prot., datë *** "Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit ndaj magjistratit Agron Bushati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër", ai ka nisur hetimin ndaj magjistratit në fjalë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d", të Ligjit për Statusin.

11. Në përfundim të hetimit disiplinor, me Vendimin nr. *** datë *** "Për përfundimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit ndaj veprimtarisë së magjistratit Agron Bushati me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër", Inspektori ka vendosur:

- i. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit z. Agron Bushati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- ii. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. Agron Bushati, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- iii. Propozimin e masës disiplinore "Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në një vit", e parashikuar nga neni 108 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- iv. Njoftimin e magjistratit z. Agron Bushati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me Raportin e Hetimit dhe me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor dhe fillimin e procedimit disiplinor për shkeljen disiplinore të përcaktuar më sipër.
- v. Njoftimin e ankuesit z. ***, me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor për shkeljen disiplinore të përcaktuar.

II. RAPORTI I HETIMIT DISIPLINOR DHE QËNDRIMI I ILD NË LIDHJE ME KËRKESËN

12. Lidhur me hetimin disiplinor, magjistrati Agron Bushati ka paraqitur parashtrimet e tij protokolluar pranë Inspektorit me nr. 2913/12 prot., datë 17.11.2023, Ai thekson, se *mbulon zyrën e ekzekutimeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër prej mbi 10 vitesh. Gjatë këtyre viteve ka përballuar shumicën e kohës, i vetëm, të gjithë ngarkesën e kësaj zyre, përfshirë dhe atë administrative, bazuar në urdhrat e Drejtuesit të Prokurorisë, si dhe administrimin e provave materiale.*

Nga magjistrati përmenden urdhrat e Drejtuesit të Prokurorisë, që i ngarkojnë përgjegjësinë dhe detyrat për ekzekutimin e vendimeve penale, si vijon:

-Urdhri nr. 2/1, datë 18.5.2016 “Për organizimin e brendshëm të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore”, ku vendoset që prokurori Agron Bushati do të trajtonte vënien në ekzekutim dhe problematikën e vendimeve penale.

-Urdhri nr. 1, datë 02.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, pika E, ku është vendosur krijimi i Zyrës për ekzekutimet dhe kërkesat e tjera në fazën e ekzekutimeve, në përbërje të së cilës është caktuar Agron Bushati si prokuror i ekzekutimeve, një oficer i policisë gjyqësore dhe një sekretare, e cila më pas me urdhrin nr. 3/1, datë 22.2.2017, është larguar, duke mbetur zyra e ekzekutimeve pa sekretar. Gjithashtu, edhe oficeri i policisë gjyqësore është larguar nga zyra e ekzekutimeve me Urdhrin nr. 6, datë 4.7.2017, duke u mbuluar sërish vetëm nga prokurori Agron Bushati.

-nisur nga ngarkesa e madhe me Urdhrin nr.1/1, datë 2.10.2017, u krijua zyra e ekzekutimeve dhe kërkesave të tjera në fazën e ekzekutimeve, ku sërish ai është caktuar si prokuror i ekzekutimeve dhe në përbërje të kësaj zyre u shtua një oficer i policisë gjyqësore.

-Urdhri nr. 2, datë 16.1.2018, ku urdhërohet krijimi i zyrës së ekzekutimeve dhe kërkesave të tjera në fazën e ekzekutimeve, ku magjistrati sërish vijon të jetë prokuror i ekzekutimeve, por, tashmë sërish pas asnjë ndihmës, oficer apo sekretar. Gjithashtu, edhe me Urdhrin nr.2, datë 29.6.2018, ka vijuar e njëjta situatë.

-Urdhri nr. ***, datë ***, për shkak të volumit të madh të punës në zyrën e ekzekutimeve u caktuan prokurori ***, prokurore *** dhe prokurori Agron Bushati. Në këtë seksion caktohen dhe dy oficerë të policisë gjyqësore.

-Në vijim, kanë dalë një sërë urdhrash të tjerë të diktuar nga lëvizjet e oficerëve apo prokurorëve, deri në momentin që aktualisht kjo zyrë është plotësuar me dy sekretarë dhe dy oficerë të policisë gjyqësore, ndërkohë që prokurori Agron Bushati vijon të jetë prokuror i vetëm i kësaj zyre.

Lidhur me rastin për të cilin ka filluar hetimi disiplinor, magjistrati ka pretenduar, se : *në asnjë moment deri në datën që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, nuk është njohur dhe as vënë në dijeni*

të vendimit penal përkatës. Një rrethanë e tillë, sipas tij, rezulton qartazi dhe nga korrespondenca me Drejtuesin e Prokurorisë, i cili sqaron se nuk jemi njohur me këtë vendim. Vendimi në fjalë, pas marrjes dijeni për problematikën, është tërhequr personalisht prej tij nga fashikulli i njohjes së vendimit të shtetasit ***, që ndodhej në Kryesekretari. Tërheqja e këtij vendimi dhe vënia në ekzekutim, është bërë pa u lënë gjurmë në ndonjë akt, pasi nisur nga fakti se nuk kishte marrë kurrë dijeni, asnjëherë, për atë vendim, nuk kishte nënshkruar në asnjë vend për marrjen në administrim të tij, nuk i ishte kaluar në asnjë moment për ekzekutim, nuk kishte asnjë arsye të dyshonte që një situatë e tillë, për të cilën nuk kishte asnjë lloj përgjegjësie, do t'i kthehej si bumerang më vonë.

Magjistrati, pretendon se vendimi në fjalë, gabimisht, nga Sekretaria apo Drejtuesi i asaj kohe, nuk është vlerësuar drejt dhe nuk i është kaluar atij, si zakonisht, për vënien në ekzekutim të tij, si çdo vendim tjetër i formës së prerë. Ky vendim i ka kaluar për dijeni vetëm prokurorit që ka përfaqësuar në atë kohë Prokurorinë në gjykim (pasi në atë periudhë rastet e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë nuk mbulohehin nga Zyra e Ekzekutimeve, por nga prokurorë të ndryshëm që caktohehin nga Drejtuesi rast pas rasti), i cili rezulton, se konform ligjit, ka njoftuar Prokurorinë e Përgjithshme për finalizimin e njohjes së vendimit dhe në asnjë moment nuk i ka kaluar për vënien në ekzekutim, si çdo vendim tjetër dënimi i formës së prerë.

Magjistrati pretendon, se lidhur me rastin në fjalë, ka marrë dijeni rastësisht gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore me objekt *** të të dënuarit ***, vëllait të shtetasit *****, i cili pas qëndrimit të tij për rrëzimin e kërkesës (qëndrim i cili u konsiderua i drejtë nga Gjykata), pas përfundimit të gjyqimit, aludoi se qëndrimi i tij ishte i qëllimshëm dhe se mund të kishte ndonjë shkak për të cilin magjistrati mbajti këtë qëndrim, sepse nuk kishte nxjerrë as urdhrin e ekzekutimit për vëllain e tij ***. Pikërisht në këtë, magjistrati pretendon se ka marrë dijeni për këtë fakt dhe është vënë kryesisht menjëherë në lëvizje, duke e verifikuar rastin në fjalë, praktikën e njohjes së vendimit të të dënuarit ***, për të cilin nuk kishte marrë asnjëherë dijeni dhe ka kryer veprimet përkatëse, nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit.

Magjistrati rriheksion faktin, se rasti në fjalë, nxjerrja me vonesë e urdhrin të ekzekutimit për të dënuarin *** nuk ka ardhur, në mënyrë kategorike, si pasojë e neglizhencës, harresës apo asnjë lloj shkeljeje tjetër të kryer prej tij, por vetëm si pasojë gabimeve të kryera nga *** apo *** i afëtershëm i Prokurorisë, të cilët në asnjë moment nuk ia kanë sigluar dhe kaluar magjistratit Agron Bushati këtë vendim për vënien në ekzekutim”.

13. Lidhur me të dhënat profesionale të magjistratit, nga dosja personale e dërguar tek Inspektori nga ana e Këshillit, rezulton se:

- i. Me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 3.9.1993, është emëruar hetues në Prokurorinë e Rrethit Pukë.
- ii. Me Dekret të Presidentit të Republikës, nr. 2923, datë 16.3.2001, Agron Bushati nga Oficer i Policisë Gjyqësore emërohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Shkodër.

- iii. Vendim nr. 178, datë 22.6.2023, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e raportit për analizimin e aftësive profesionale të prokurorit Agron Bushati”.
- iv. Urdhër nr. 248, datë 30.11.2005, për dhënie mase disiplinore nga Prokurori i Përgjithshëm për shkelje të kryera nga ana e prokurorit Agron Bushati të masës disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”*, për zvarritje të një procedimi penal pa kryer asnjë veprim hetimor.
- v. Materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të prokurorit Agron Bushati, filluar me Urdhrin nr.167/1, datë 11.10.2007, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- vi. Urdhër nr. 167/1, datë 11.10.2007, i Prokurorit të Përgjithshëm “Për pezullim nga detyra” të prokurorit Agron Bushati të Prokurorisë së Rrethit Shkodër.
- vii. Urdhër nr. 41, datë 8.2.2008, i Prokurorit të Përgjithshëm për dhënie mase disiplinore prokurorit Agron Bushati të masës disiplinore *“Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 viti”*, duke u transferuar për këtë periudhë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, për shkak të zvarritjeve në kryerjen e veprimeve hetimore në procedimin penal ndaj të pandehurve V. SH dhe A. SH, si dhe mosdorëzim të procedimeve penale nr. 140/2000, nr.279/2003, nr.192/2005.
- viii. Diplomë dhe listë notash e fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
- ix. Vlerësim i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2012, për prokurorin Agron Bushati, me vlerësimin “Shumë mirë”.
- x. Vlerësim i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2013, për prokurorin Agron Bushati, me vlerësimin “Mirë”.
- xi. Vlerësim i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2014, për prokurorin Agron Bushati, me vlerësimin “Mirë”.
- xii. Vlerësim i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2015, për prokurorin Agron Bushati, me vlerësimin “Shumë mirë”.
- xiii. Vlerësim i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2016, për prokurorin Agron Bushati, me vlerësimin “Shumë mirë”.

14. Me Shkresën nr. 2913/7 prot., datë 24.10.2023, Inspektori ka kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, e cila ka dërguar informacionin e kërkuar dhe ka sqaruar funksionimin e zyrës së ekzekutimit të vendimeve penale në këtë prokurori, në bazë të urdhrave të Drejtuesit të Prokurorisë të përmendur në parashtrimet e mësipërme të magjistratit.

- Ndër të tjera për prokurorin Agron Bushati, sipas Urdhrit të Drejtuesit të Prokurorisë nr. 2, datë 29.6.2018 “Për detyrat funksionale të punonjësve të administratës”, është përcaktuar, se: *“Prokurori i seksionit të ekzekutimeve penale merr masat për vënien në ekzekutim të menjëhershëm të çdo vendimi të formës së prerë, si dhe në veçanti të çdo vendimi që ka të bëjë me lirinë e personit”. Për çdo vendim gjyqësor penal të ekzekutueshëm krijohet fashikull më vete i inventarizuar. Veprimet e kryera për ekzekutimin, pasqyrohen në regjistrin e ekzekutimit të vendimeve penale, i cili plotësohet në çdo zë të tij. Prokurori i*

ekzekutimit të vendimeve penale brenda 6 - muhorit të parë të vitit pasardhës, dorëzon në arkiv të gjitha dokumentet e vitit paraardhës, përveç rasteve kur praktika është ende në trajtim prej tij".

- Gjithashtu, me Urdhrin nr. 2/1, datë 20.3.2019 të Drejtuesit të Prokurorisë "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 2, datë 29.06.2018 "Për detyrat funksionale të punonjësve të administratës", pika 2 dhe 3, janë përcaktuar detyrat e prokurorit të Zyrës së Ekzekutimeve dhe sekretarit të Zyrës së Ekzekutimeve, të caktuar po këtë ditë.
- Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë, nr. 19, datë 26.04.2019 "Për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti", pika I, është vendosur: *Përjashtimin e fashikujve të procedimit penal, për të cilat ushtrimi i ndjekjes penale është kryer nga prokurori Agron Bushati, nga shorti elektronik dhe manual i ndarjes së çështjeve në seksionin në të cilin ai bën pjesë, për shkak të barazisë të shpërndarjes së ngarkesës ndërmjet prokurorëve.*
- Me Urdhrin, nr. ***, datë *** "Për përjashtimin e fashikujve të procedimit penal nga shorti", (***) fashikuj, të cilët ndodhen në fazën e (***) sipas procesverbalit përkatës, do të shortohen manualisht, duke përfshirë në short edhe prokurorët e Zyrës së ekzekutimeve Z. Agron Bushati dhe Z. ***.
- Urdhri i Drejtuesit të Prokurorisë, nr. ***, datë *** "Për verifikimin e zbatimit të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm", pika 3, ngarkon prokurorin e Zyrës së Ekzekutimeve z. Agron Bushati, përveç punës në këtë Zyrë, të evidentojë çështjet penale të përfunduara me vendim gjyqësor të shkallës së parë ose të pushuara nga organi i Prokurorisë, për periudhën ***, si dhe të përpilojë informacion, i cili duhet të përmbajë të dhëna për subjektin, për veprën penale, si dhe mënyrën e përfundimit të procedimit penal ndaj subjektit të shoqëruar me aktet procedurale përkatëse.
- Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë, nr. ***, datë *** "Për një ndryshim në Urdhrin nr. *** datë *** "Për riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër", Drejtues i Seksionit 4, "Për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë", caktohet prokurori Agron Bushati, me daljen *** të prokurorit ***.
- Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë, nr. ***, datë *** "Për krijimin e komisionit të trajtimit të provave materiale", krijohet Komisioni i Trajtimit të Provave Materiale në Prokurori, me kryetar prokurorin Agron Bushati dhe anëtar oficerin e policisë gjyqësore *** dhe sekretarët *** dhe ***.
- Me Urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë, nr. ***, datë *** "Për ngritjen e komisionit të ekspertizës", prokurori Agron Bushati, oficeri i policisë gjyqësore **** dhe sekretarja ***

bëhen pjesë e këtij komisioni, duke u ngarkuar edhe me përgjegjësitë e Komisionit të Ekspertizës, sipas detyrave të përcaktuara në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2023 "Për arkivat" dhe "Normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".

- Prokurori Agron Bushati gjatë periudhës që ka qenë pjesë e Seksionit të Ekzekutimeve, ka pasur nën administrim dhe ngarkesë edhe provat materiale, për sa i përket sistemit, kthimit të tyre në momentin që vendimi ka marrë formë të prerë dhe procedurës së asgjësimit.
- Prokurori Agron Bushati, aktualisht, vijon të mbajë pozicionin e prokurorit të Zyrës së Ekzekutimeve dhe Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, të cilin e mban prej shumë vitesh në këtë Prokurori dhe është Drejtuesi i këtij Seksioni.

15. Pas kërkesës së Inspektorit, për administrimin e një kopje të kërkesave-ankesave të ankuesit *** drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe magjistratit z. Agron Bushati, rezulton se: Nga këqyrja e librit të protokollit të korrespondencës me qytetarët, rezulton që me Nr. *** prot., datë *** të jetë administruar kërkesa e shtetasit ***, më anë të së cilës vihet në dijeni prokuroria se:

*"Jam *** dhe më datë *** jam arrestuar për efekt ***. Më datë *** Gjykata Shkodër ka vlerësuar arrestin në flagrancë, duke caktuar arrest me burg, deri në njohjen e vendimit të huaj.*

*Çështja e njohjes së vendimit të huaj ka kaluar nga Gjykata Shkodër në Apel, në Gjykatën e Lartë e më pas, pas rishqyrtimit Gjykata e Apelit ka caktuar ndaj meje me *** vite burg. Është bërë kërkesë për llogaritje paraburgimi deri në ditën që ky vendim ka marrë formë të prerë, por gjykata ka vendosur të më njohë si periudhë paraburgimi, periudhën nga *** në vendimin e saj, datë ***, i cili ka marrë formë të prerë (nuk e di datën).*

*Unë, deri më sot nga Burgu ***mbahem në paraburgim, për arsye se prokurori nuk ka dërguar Urdhër Ekzekutimi.*

Kërkoj të më bëhet Urdhri i ekzekutimit, sa më shpejt, që unë të dal nga gjendja e paraburgimit dhe përgjigjen tuaj zyrtare e kërkoj të më vihet në dispozicion personalisht."

16. Kësaj kërkesë i është kthyer përgjigje me Shkresën me nr. *** prot., datë ***, të prokurorit Agron Bushati. Në këtë përgjigje të magjistratit thuhet se:

*"Në kërkesën tuaj pretendoni se nga ana e prokurorit nuk është lëshuar urdhër ekzekutimi për një vendim penal që i ka njohur një periudhë paraburgimi dhe pas verifikimit të bërë, rezulton se në datën *** është depozituar Vendimi penal nr. ****, datë ***, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt: "llogaritje paraburgimi", ku në përfundim gjykata*

ka vendosur të shpallë moskompetencën e çështjes në fjalë, duke dërguar aktet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Vendim tjetër gjyqësor pranë nesh, nuk ka të regjistruar.”

17. Nga informacioni i dërguar Inspektorit nga Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër për të dhënat statistikore të Zyrës së Ekzekutimeve mbi "Ekzekutimet e vendimeve penale", "Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë", "Urdhrat e arrestit ndërkombëtar", "Ekstradimet", në bazë të raporteve vjetore të prokurorisë të viteve 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, rezulton se:

- gjatë vitit 2017 janë vënë në ekzekutim të gjitha vendimet penale të formës së prerë, duke respektuar afatet ligjore të parashikuara në nenin 49, të Ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", të ndryshuar.
- gjatë vitit *** janë lëshuar *** urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale, ku përfshihen vendime me burg, vendime me gjobë, vendime për nenin 59 të K. Penal, nenin 59/a të K. Penal dhe vendime sipas nenit 63 të K. Penal. Janë dërguar për jashtë shtetit *** kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale; janë ekzekutuar *** kërkesa për ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja; nga autoritetet gjyqësore të huaja, kanë ardhur për t'u ekzekutuar *** kërkesa për ndihmë juridike, ku *** kërkesa janë ekzekutuar; janë dërguar *** kërkesa për ekstradim të kërkuara nga autoritetet gjyqësore të huaja; ka pasur *** kërkesa për njohje të vendimeve penale të dhëna nga autoritetet gjyqësore të huaja; për *** raste është kërkuar shpallja e kerkimit ndërkombëtar nga ana e prokurorëve.
- gjatë vitit 2018, janë lëshuar *** urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale; janë paraqitur gjithsej *** kërkesa ekstradimi për shtetasit shqiptarë apo të huaj; janë paraqitur gjithsej *** kërkesa ekstradimi për shtetas shqiptarë apo të huaj. Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2018 janë transmetuar *** letër porosi. Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale dërguar autoriteteve të huaja, gjatë vitit 2018 janë transmetuar *** letër porosi. Referuar të dhënave statistikore, rezulton se për vitin 2018 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej *** kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale. Gjatë vitit 2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka shpallur në kerkim ndërkombëtar gjithsej *** shtetas.
- Prokurori Agron Bushati rezulton që gjatë vitit 2018 të ketë trajtuar edhe 51 procedime penale.
- gjatë vitit 2019, janë vënë në ekzekutim të gjitha vendimet penale të formës së prerë. Janë nxjerrë dhe vënë në ekzekutim, lëshuar *** urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale. Gjithashtu, *** urdhra janë nxjerrë më vete, vetëm në lidhje me pagimin e shpenzimeve procedurale. Gjatë këtij viti janë dërguar për jashtë shtetit *** kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale; janë ekzekutuar *** kërkesa për ndihmë juridike nga autoritetet

gjyqësore të huaja; nga autoritetet gjyqësore të huaja, kanë ardhur për tu ekzekutuar 6 kërkesa për ndihmë juridike. Gjithashtu, janë dërguar *** kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit nga autoritetet gjyqësore të huaja pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Ka pasur *** kërkesa për njohje të vendimeve penale të dhëna nga autoritetet gjyqësore të huaja.

- gjatë vitit 2020 ka qenë i ngarkuar me ekzekutimet e vendimeve të formës së prerë dhe ekzekutimin e letër- porosive prokurori Agron Bushati. Gjatë vitit 2020, janë nxjerrë dhe vënë në ekzekutim, duke u lëshuar *** urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale; Gjithashtu, po kaq urdhra janë nxjerrë edhe në lidhje me pagimin e shpenzimeve procedurale. Gjatë këtij viti janë dërguar për jashtë shteti *** kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale; janë ekzekutuar *** kërkesa për ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja; nga autoritetet gjyqësore të huaja, kanë ardhur për tu ekzekutuar *** kërkesa për ndihmë juridike. Gjithashtu, janë dërguar *** kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit nga autoritet gjyqësore, të cilat janë vënë në ekzekutim duke paraqitur kërkesat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; ka pasur *** kërkesa për njohje të vendimeve penale të dhëna nga autoritet gjyqësore të huaja, të cilat janë në proces ekzekutimi.
- gjatë vitit 2021 ka qenë i ngarkuar me ekzekutimet e vendimeve të formës së prerë dhe ekzekutimin e letër porosive prokurori Agron Bushati. Gjatë vitit 2021, janë nxjerrë dhe vënë në ekzekutim duke u lëshuar *** urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale; Gjithashtu, po kaq urdhra janë nxjerrë edhe në lidhje me pagimin e shpenzimeve procedurale, për secilin vendim dhe procedim penal të përfunduar. Gjatë këtij viti janë dërguar për jashtë shtetit *** kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale; Janë ekzekutuar 6 kërkesa për ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, si dhe janë ekzekutuar edhe një sërë kërkesash, rreth *** të dërguara nga vitet e mëparshme; Nga autoritet gjyqësore të huaja, kanë ardhur për tu ekzekutuar, *** kërkesa për ndihmë juridike; Gjithashtu, janë dërguar *** kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit nga autoritetet gjyqësore të huaja; Ka pasur *** kërkesa për njohje të vendimeve penale të dhëna nga autoritetet gjyqësore të huaja.

18. Në funksion të hetimit disiplinor, nga ana e Inspektorit është vendosur paraqitja pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe marrja e dokumentacionit në këtë prokurori, veprim i cili është realizuar në datën ***

Me procesverbalin e datës *** "Për marrjen e akteve shkresore", janë administruar kopje të fletëve nga regjistri i ekzekutimeve për shtetasin *** , si dhe aktet si urdhër lirimi, vendime gjyqësore, si dhe urdhër për ekzekutimin e Vendimit nr. *** , datë *** , ndërsa me procesverbalin e datës *** , është bërë një këqyrje e regjistrave të ekzekutimeve, ku janë administruar edhe fletë të këtyre regjistrave. Gjithashtu, me procesverbalin e datës *** , janë marrë shpjegime nga punonjësja e

sekretarisë znj. ***, punonjëse e sekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

19. Me shkresën nr. *** prot., datë *** të Inspektorit janë kërkuar të dhëna shtesë për hetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, si kopje e praktikave të ekzekutimeve të vendimeve penale me burgim brenda të njëjtës periudhë me vonesën në ekzekutimin e vendimit objekt- hetimi, shoqëruar më kopje të regjistrit të ekzekutimeve, si dhe kopje të dosjes së njohjes së vendimit penal të juaj për shtetasin ***. Në përgjigje të kësaj shkrese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me shkresën nr. ***, datë ***, ka referuar se e kanë të pamundur objektivisht që të realizohet për shkak të volumit shumë të madh të kateve dhe mungesës së kohës efektive në dispozicion.

20. Në vijim të hetimit disiplinor, Inspektori ka kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme ankesat e depozituara nga shtetasi *** në periudhën ***, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. ***, datë ***, duke dërguar informacionin e kërkuar. Në Prokurorinë e Përgjithshme në datën ***, është paraqitur një ankesë nga shtetasi ***, në të cilën pretendon se ka ***vjet që vazhdon të qëndroj dhe trajtohet si i paraburgosur pranë IEVP *** dhe pse ndaj tij ka përfunduar gjykimi dhe në Gjykatën e Apelit. Me Shkresën nr. *** datë *** të Prokurorisë së Përgjithshme, kjo ankesë i është dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për zgjidhje ligjore.

21. Me shkresën nr. *** prot., datë *** të Inspektorit janë kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, ankesa të shtetasit *** të depozituara në periudhën ***, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. ***, datë ***, duke vendosur në dispozicion ankesat me nr.***, datë ***; ankesa me nr. ***, datë ***; ankesa me nr. ***, datë ***. Edhe në këto ankesa, ai ka pretenduar se vijon të qëndrojë në mjediset e paraburgimit të IEVP *** dhe trajtohet si i tillë, me statusin e personit të paraburgosur, pavarësisht se është dënuar me vendim penal të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Shkodër. Ankesa me nr. ***, datë *** nga Ministria e Drejtësisë i është dërguar me shkresën nr. ***, datë *** Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP *** për verifikimin e pretendimeve. Gjithashtu, me shkresën nr. ***, datë *** të Ministrisë së Drejtësisë ankesa nr.***, datë *** i është dërguar IEVP ***.

22. Me shkresën nr. *** prot., datë *** të Inspektorit është kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme, kopje e praktikës së njohjes së vendimit penal të huaj për shtetasin ***, e cila ka përcjellë këtë praktikë me shkresën nr.***, datë ***. Në përmbajtje të kësaj praktike rezulton Shkresa me nr. ***, datë ***e Prokurorisë së Apelit Shkodër, me të cilën i dërgohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër Vendimi nr. ***, datë *** i Gjykatës së Apelit Shkodër në ngarkim të pandehurit ***. Rezulton dhe Shkresa nr.***, datë ***, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me të cilën i dërgohet Prokurorisë Shkodër vendimi për shtetasin ***, nr. ***, datë ***, marrë formë të prerë me vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër nr. ***, datë ***, ndërsa me shkresën nr. ***, datë ***, të Prokurorisë Shkodër ky vendim i është dërguar Prokurorisë së Përgjithshme.

23. Sipas Inspektorit, bazuar në dokumentacionin e administruar në kuadër të këtij procesi hetimor, rezultojnë të provuara faktet si më poshtë:

- Magjistrati Agron Bushati ushtron detyrën e prokurorit^[1] në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale.
- Hetimi disiplinor i filluar nga Inspektori lidhet me veprimtarinë e magjistratit Agron Bushati, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.
- Lidhur me faktet objekt hetimi mbi veprimtarinë e prokurorit Agron Bushati, që reflektohet në vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, rezulton e provuar se:

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.***, datë *** ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. *** datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë mënyrë:

- *"Njohjen e vendimit penal nr. ***, datë *** të Gjykatës së *** Itali dhe dënimin e *** me *** burg për veprën penale të parashikuar nga neni 624,625 n.7, 61, n.5 K. Penal Italian, e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal Shqiptar.*
- *"Njohjen e vendimit penal nr. *** të Gjykatës së Apelit *** dhe dënimin e *** me *** muaj burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 73 dhe 80 të dekretit 309/1990, nenit 81 cpv, nenit 110 dhe 648 K.P, nenit 2 të ligjit 895/67, ligji italian dhe të parashikuara nga nenet 278/3 e 283/a/2 të Kodit Penal Shqiptar.*
- *Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, *** dënohet përfundimisht me *** vite burgim."*
- Nga verifikimi i librit të korrespondencës së dërgimit të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për vitet ***, rezultoi se nga ana e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën ***, pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë Shkodër, është dërguar Vendimi me nr. *** datë ***, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shënimet e vendimmarrjes së Vendimit nr. ***** datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër, provuar kjo nga fleta e regjistrit të korrespondencës së cituar më lart, me nr. rendor.***, marrë në dorëzim nga personi i autorizuar kundrejt nënshkrimit. Ndërsa, fashikulli gjyqësor me nr. vendimi *** datë ***,

[1] Magjistrati Agron Bushati është konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 702, datë 27.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim i cili është ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku është regjistruar çështja (JR) nr. 53/2023, datë 09.11.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që lidhet me subjektin e rivlerësimit Agron Bushati.

i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi bazën e rekursit të ushtruar nga i dyshuari *** , ndodhet pranë Gjykatës së Lartë që prej datës ***.”

- Nga aktet e administruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë verifikimit në vend, rezulton edhe shkresa nr. *** , datë *** e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër drejtuar prokurorisë, sipas të cilës dërgohet për ekzekutim vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. *** , datë *** për njohje vendimi penal të huaj për shtetasin *** , bashkëlidhur dhe vendimi, e cila është sigluar për arkivim (pas ky vendim është ekzekutuar me parë).
- Sipas informacionit të IEVP *** , me shkresën nr. ***A.B, datë *** është dërguar Urdhër Ekzekutimi në lidhje me ekzekutimin e Vendimit *** , datë *** të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe marrë formë të prerë me vendimin Nr. *** , datë *** të Gjykatës së Apelit Shkodër. Me shkresën nr. *** Prot, datë *** “Kërkesë për ***.. ” të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektorit Ligjor dhe Kartotekës Tiranë është kërkuar transferimi nga seksioni i paraburgimit në IEV Penale *** në seksionin e të dënuarve në një nga IEVP-të për shkak të marrjes së vendimit të dënimit të formës së prerë, duke kaluar me statusin e të dënuarit. Me Urdhër nr. *** Prot, datë *** të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është urdhëruar transferimi i të burgosurit *** , nga seksioni i paraburgimit në seksionin e të dënuarve në IEVP ***.”
- Më Kërkesën Nr. *** prot., datë *** të shtetasit *** , rezulton që magjistrati Agron Bushati të jetë vënë në dijeni për mos nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit në pjesën, ku thuhet :*“Është bërë kërkesë për llogaritje paraburgimi deri në ditën që ky vendim ka marrë formë të prerë por gjykata ka vendosur të më njohë si periudhë paraburgimi periudhën nga *** në vendimin e saj datë *** , i cili ka marrë formë të prerë (nuk e di datën). Unë deri më sot nga Burgu *** mbahem në paraburgim për arsye se prokurori nuk ka dërguar Urdhër Ekzekutimi.*
- *Kërkoj të më bëhet Urdhri i ekzekutimit sa më shpejt që unë të dal nga gjendja e paraburgimit dhe përgjigjen tuaj zyrtare e kërkoj të më vihet në dispozicion personalisht.”*
- Nga praktika e Prokurorisë së Përgjithshme të njohjes së vendimit penal të huaj për shtetasin *** , rezulton se me shkresën nr. *** , datë *** , Prokuroria e Apelit Shkodër i ka dërguar për ekzekutim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, vendimin nr. *** , datë *** të Gjykatës së Apelit Shkodër, në ngarkim të pandehurit ***.
- Nga shqyrtimi i dinamikës së vuajtjes së dënimit vihet re se i dënuari *** me periudhën e paraburgimit ka përfutur *** ulje dënimi, ndërsa nuk rezulton të ketë përfutur ulje të tjera dënimi (ulje dënimi nëpërmjet vendimit të gjykatës).”

24. Në analizë ligjore të fakteve të konstatuara, **Inspektori vlerëson se:**

- Në rastin konkret nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik, i cili dikton mbylljen e këtij hetimi disiplinor.
- Shkeljet disiplinore lidhen me veprimtarinë e prokurorit Agron Bushati në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në periudhën nga viti *** dhe si një sjellje e tillë vazhduese konsiderohet të jetë brenda afatit 5- vjeçar të parashkrimit.
- Nuk rezulton të ketë vendim për pezullim hetimi disiplinor.
- Nuk ekziston rrethanë faktike apo element juridik për mbylljen e hetimit disiplinor për çështje statusi të magjistratit.
- Nuk rezulton që çështja të ketë qënë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendimi i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor.
- Neni 101, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të Ligjit për Statusin, përcakton se: *Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: “a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyllje të detyrës,*
- Neni 102, pika 1, shkronja “d” e Ligjit për Statusin, përcakton si shkelje “vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale.”
- Rezultatet e hetimit disiplinor nuk të çojnë drejt përfundimit të pamjaftueshmërisë së provave për të provuar shkeljen disiplinore dhe për rrjedhojë, nuk ekzistojnë rrethana për mbylljen e hetimit disiplinor.

25. Për të vlerësuar nëse nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e saj profesionale, në mbështetje të nenit 101, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet nëse veprimi apo mosveprimi e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merren parasysh një sërë faktorësh si: (a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); (b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; (c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; (ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe (d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

26. Sipas Inspektorit, hetimi disiplinor ndaj prokurorit Agron Bushati lidhet me zvarritjen e pajustificuar në nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për një vendim penal dënimi të formës së prerë,

që lidhet me të dënuarin ***. Ky shtetas është dënuar me Vendimin nr. ***, datë ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vendim i cili ka marrë formë të prerë me Vendimin nr. ***, datë *** të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe është dërguar për ekzekutim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në datën ***.

27. Në Ligjin për Statusin, nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda. Për të arritur në një përfundim të qartë në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore, duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, të parashikuara nga neni 115 i Ligjit për Statusin, në raport me faktet e provuara në këtë proces disiplinor. Ky nen parashikon në mënyrë jo shteruese, si kriterë për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore:

- (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes;
- (b) shkalla e fajësisë dhe motivi;
- (c) pasojat e shkeljes;
- (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit;
- (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore;
- (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen;
- (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit;
- (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit;
- (f) sjellja e magjistratit gjatë hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij;
- (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

28. Sipas Inspektorit, në analizë të kriterit “mbi llojin dhe rrethanat e shkeljes”, magjistrati ka vonuar në mënyrë të pajustificuar nxjerrjen e një akti procedural në shkelje të dispozitave ligjore neneve 462-466 të K. Pr. Penale dhe nenin 49/1 të Ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar. Kjo shkelje është e natyrës që magjistrati duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.

Urdhri i ekzekutimit është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal. Referuar neneve 462-466 të K. Pr. Penale, vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë, pasi të ketë marrë formë të prerë, nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin, duke realizuar njoftimet përkatëse. Për rastin konkret, siç parashikon neni 59, i ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, vendimi penal i huaj, pas njohjes, ekzekutohet në përputhje me nenin 518 të Kodit të Procedurës Penale. Referuar nenit 518, të K. Pr. Penale, pasi janë njohur vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar, prokurori pranë gjykatës që ka bërë njohjen e vendimit merr masa për ekzekutimin e tij. Për vendimin me burgim, kur i dënuari është i paraburgosur, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit, i cili i dërgohet IEVP dhe të dënuarit dhe mbrojtësit të tij, pasi të këtë bërë llogaritjet e paraburgimit ose dënimeve të shlyera dhe të jetë caktuar koha e dënimit me burgim që duhet të

vuajë i dënuari. Në urdhrin e ekzekutimit prokurori përcakton edhe llojin e sigurisë që duhet të ketë vendi i kryerjes së dënimit.

Në kohën që nga prokurori është nxjerrë urdhri i ekzekutimit, me datë ***, ishte në fuqi Ligji nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i cili parashikon, se prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal, në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e ligjit si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në bazë të nenit 64, shkronja "a", të këtij Ligji, për dënimet me burgim me të paraburgosur, prokurori kryen veprimet paraprake dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit.

Në kohën e marrjes formë të prerë të Vendimit nr. ***, datë *** të Gjykatës së Apelit Shkodër, ligji i posaçëm për ekzekutimin e vendimeve penale, në fuqi ishte Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar. Në nenin 22 të këtij Ligji parashikohej, se: *"Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim". Kur i dënuari ka qenë i paraburgosur, në urdhrin e ekzekutimit saktësohen koha e vuajtur dhe pjesa që mbetet për të vuajtur, sipas kriterëve të nenit 57 të Kodit Penal. Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriterëve të ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", prokurori përcakton llojin e institucionit ku i dënuari do të vuajë dënimin dhe nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve saktëson institucionin konkret."* Kur i dënuari është i paraburgosur urdhri i dërgohet organit ku ai mbahet. Për sa i përket afateve të ekzekutimit të vendimeve në nenin 49/1, të këtij Ligji parashikohej, se: ***për dënimet me burgim , me të paraburgosur, prokurori lëshon urdhrin e ekzekutimit menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 48 orë nga ardhja e vendimit penal.***

29. Sipas Inspektorit, nga ana e magjistratit Agron Bushati, si prokuror i ngarkuar me nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit të Vendimit penal nr. ***, datë ***, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shënimet e vendimmarrjes së Vendimit nr.*** datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër, nuk rezulton të jetë kryer nxjerrja e këtij urdhëri, në përputhje me parashikimet e neneve 462-466 dhe 518 të K. Pr. Penale dhe nenin 49/1 të Ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar. Rezulton, që Vendimi nr. ***, datë ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ka marrë formë të prerë me Vendimin nr. *** datë ***, të Gjykatës së Apelit Shkodër, me shënimet e vendimmarrjes së formës së prerë, t'i jetë komunikuar nga gjykata prokurorisë në datën ***, t'i jetë dërguar gjithashtu me shkresën nr. ***, datë *** të Prokurorisë së Apelit Shkodër, të jetë kërkuar nga shtetasi ***, të paktën sa provohet me Kërkesën Nr. ***, datë ***, ndërsa urdhëri i ekzekutimit për të është nxjerrë me nr. ***, me datë ***. Vendimi është marrë me firmë nga ana e sekretares *** në atë kohë e ngarkuar me mbajtjen e protokollit, e cila ka konfirmuar në shpjegimet e saj se është marrë prej saj zarfi me vendimet e gjykatës dhe i është dorëzuar kryesekretares znj. ***, e cila në vitin *** deri në gusht *** ka qenë edhe *** e në zyrën e ekzekutimeve, caktuar me Urdhërin nr. ***, datë ***.

30. Rezulton se i dënuari *** të ketë vuajtur dënimin në I.E.V.P., duke qëndruar në statusin e të paraburgosurit për periudhën ***, gjë që rezulton nga fakti, se pas dërgimit me shkresën e Prokurorisë Shkodër nr. ***/A.B, datë *** të urdhërit të ekzekutimit, me Urdhër nr. *** Prot, datë *** të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është urdhëruar transferimi i të burgosurit ***, nga seksioni i paraburgimit në seksionin e të dënuarve në IEVP ***. Pra, edhe pse urdhëri i ekzekutimit mban datën ***, ai rezulton se nuk është dërguar pranë IEVP *** deri në datën ***, gjë që rezulton edhe nga ankesat në vazhdim të shtetasit *** në muajin qershor dhe korrik të vitit *** pranë Inspektorit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Nga momenti që është dorëzuar vendimi i formës së prerë në prokurori në datën ***, e deri sa ka dalë urdhëri i ekzekutimit datë ***, rezulton se ka kaluar një kohë prej *** dhe deri në datën ***, afërsisht *** vjet.

31. Si pasojë e mos nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit, shtetasi *** ka kërkuar në gjykatë njohjen si periudhë paraburgimi nga data ***, e deri në momentin e ekzekutimit të vendimit të pa ekzekutuar. Në bazë të Vendimit nr. ***, akti datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ***, ku është pranuar pjesërisht kërkesa e shtetasit ***, për t'i njohur dhe llogaritur si periudhë paraburgimi nga data e arrestimit *** deri në ditën që është dhënë vendimit nga Gjykata e Apelit Shkodër datë ***, dhe jo deri në ekzekutimin e vendimit, rezulton se për këtë shtetas nuk ka pasur dinamikë të vuajtjes së dënimit nga IEVP *** , ku ndodhej shtetasi ***, pasi në përgjigjen e IEVP *** citohej, se : ky shtetas ishte i paraburgosur dhe si i tillë nuk mund të bëhej dinamikë, pasi nuk dispononin vendimin e formës së prerë. Gjithashtu, rezultonte se nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është nxjerrë vetëm Urdhër për ekzekutimin e vendimit penal, me nr. ***, datë *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u cituar që shtetasi ***, të dërgohet në dhomat e paraburgimit. Nuk rezulton se është nxjerrë urdhër tjetër ekzekutimi, në lidhje me shtetasin ***.

32. Referuar Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, i shfuqizuar me Ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në rastin konkret, trajtimi me status të paraburgosuri cenon ushtrimin e të drejtave që ka i dënuari me burgim, si përfitimi i lejeve shpërblyese ose kërkesat për ulje dënimi.

33. Pas nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit me datë ***, rezulton se të dënuarit *** i është llogaritur edhe dinamika e vuajtjes së dënimit që nga marrja formë të prerë e vendimit të njohjes, e konkretisht sipas shkresës nr. ***, datë *** të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga përlllogaritjet e kryera nga IEVP *** në datën *** nga dënimi i dhënë ndaj tij ka vuajtur *** ditë burgim dhe i mbeten për të vuajtur edhe *** ditë burgim, e më pas nga ky i dënuar është paraqitur në datën *** dhe kërkesë për lirim me kusht, nga e cila në seancën e datës *** kërkuuesi ka hequr dorë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me Vendimin nr. ***, datë ***, ka vendosur deklarin e papranueshëm të kësaj kërkesë penale. Gjithashtu, pas nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit ky shtetas ka përfituar *** herë ulje dënimi, *** vit me Vendimin nr. ***, datë ***, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe *** ditë ulje dënimi me Vendimin nr.

***, datë ***, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe ***ditë ulje dënimi me Vendimin nr. ***, datë ***, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

34. Shtetasi ***, me Urdhër nr. ***, datë ***, të IEVP Shkodër është liruar, pasi nga dënimi i dhënë ka vuajtur gjithsej *** dite burgim, duke i mbetur për të vuajtur edhe *** burgim, periudhë e amnistuar, sipas nenit 5, pika 1, shkronja b) të Ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”.

35. Sipas Inspektorit, duke vepruar në kundërshtim të hapur me dispozita ligjore të mësipërme, rezulton të jemi para elementëve të shkeljes disiplinore të parashikuar në nenin 102 pika 1, shkronja “d”, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet si shkelje disiplinore “*vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale.*”

36. Në analizë të kriterit të “**shkallës së fajësisë dhe motivi**”, shkelja disiplinore nga ana e magjistratit Agron Bushati është kryer me pakujdesi, duke qenë prokurori i ngarkuar edhe me përgjegjësinë e zyrës së ekzekutimit të vendimeve penale, vërtetuar kjo nga fakti i vënies në dijeni me kërkesën e shtetasit ***, të cilës i është kthyer përgjigje nga vetë magjistrati, me ***, datë ***, pasi me anë të kësaj kërkesë magjistrati është vënë në dijeni të mosnxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit, ndërkohë që me përgjigjen e kthyer është keqinterpretuar kjo kërkesë.

37. Në analizë të kriterit “**pasojë e shkeljes**” të sjelljes dhe veprimeve të magjistratit, rezulton se ky mosveprim ka cënuar të drejtat që gëzojnë të dënuarit me burgim. Në rastin konkret trajtimi me status të paraburgosuri cenon ushtrimin e të drejtave që ka i dënuari, së pari ai nuk mund të ushtronte të drejtat e tij për përfitimin e lejeve shpërblyese ose kërkesat për ulje dënimi, parashikuar përkatësisht në nenet 72 dhe 75 të Ligjit nr. 81/2020 ose në ligjin e mëparshëm nr. 8338, datë 16.4.1998 nenet 59 dhe 63 të tij. Për këtë shkak, uljet e dënimit janë përfituar prej tij gjatë viteve tetor *** pas dërgimit në IEVP të urdhërit të ekzekutimit në Korrik 2021. Së dyti, cenohej e drejta e tij për të paraqitur kërkesë për lirim me kusht, të cilën e ka paraqitur pas uljeve të dënimit të përfituara si më sipër. Së treti, shtetasit *** në funksion të kërkesave të mësipërme nuk mund t’i kryhej dinamikë e vuajtjes së dënimit të përcaktuar në nenin 38, të Ligjit nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale ose neni 31/6 i Ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998), siç ka rezultuar në rastin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për njohje paraburgimi.

38. Në analizë të kriterit “**të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit**”, magjistrati Agron Bushati është emëruar si prokuror në vitin 2001. Lidhur me vlerësimet e magjistratit, rezulton se ai ka 5 vlerësime të punës nga Prokurori i Përgjithshëm, në vitet 2012 – 2016, ndër të cilat 2 vlerësime “mirë” dhe 3 vlerësimet e tjera “shumë mirë”.

39. Rezulton se, pranë Zyrës së Inspektorit janë paraqitur:

- **Ankesa në të cilat janë ngritur pretendime për veprime/mosveprime apo vendimmarrje të padrejtë nga ana e magjistratit, z. Agron Bushati:**

Ankuesi, z. ***, i është drejtuar Inspektorit, me ankesën me nr. *** prot., datë ***. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori me Vendimin nr. ***, datë *** “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës”, ka vendosur arkivimin e ankesës.

Ankuesi, z. ***, i është drejtuar Inspektorit, me ankesën me nr. *** prot., datë ***. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori me Vendimin nr. ***, datë *** “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës”, ka vendosur arkivimin e ankesës.

Ankuesi, z. ***, i është drejtuar Inspektorit, me ankesën me nr. *** prot., datë ***. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori me Vendimin nr. ***, datë *** “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës”, ka vendosur arkivimin e ankesës.

- **Ankesa në të cilat janë ngritur pretendime për zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, nga ana e magjistratit, z. Agron Bushati:**

Ankuesi, z. ***, i është drejtuar Inspektorit, me ankesat me nr. *** prot., datë *** dhe nr. *** prot., datë ***. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara Inspektori, me Vendimin nr. ***, datë *** “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. ***”, Inspektori ka vendosur arkivimin e ankesave të bashkuara.

Ankuese, znj. *** i është drejtuar Inspektorit, me ankesën e regjistruar me nr. *** prot., datë ***. Pas verifikimit të ankesës, Inspektori me Vendimin nr. ***, datë *** “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës”, ka vendosur arkivimin e ankesës.

Ankuesi, *** i është drejtuar Inspektorit me ankesën nr. *** prot., datë ***, ankesë e cila ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar nga inspektor, z. ***.

- **Ankesa në të cilat janë ngritur pretendime për shkelje disiplinore ndaj magjistratit z. Agron Bushati:**

Me projektvendimin nr. *** prot., datë *** “Për verifikimin me iniciativë ndaj magjistratëve z. ***, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor *** në kohën e shkeljes së pretenduar dhe z. Agron Bushati, prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në kohën e shkeljes së pretenduar”, është propozuar verifikimi i të dhënave lidhur me veprimtarinë e gjyqtarit z. ***, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ***, si dhe lidhur me veprimtarinë e prokurorit z. Agron Bushati, prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në kohën e shkeljes së pretenduar, sipas konstatimeve në raportin e inspektimit “Mbi kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”. Rasti në fjalë ka të bëjë me lirin me kusht të një të dënuari, në kundërshtim me kriteret

e nenit 64 të K. Penal, pa plotësuar kohën vuajtjes fizike të përcaktuar në këtë dispozitë, ku magjistrati ka përfaqësuar çështjen.

Gjithashtu pranë Inspektorit është përcjellë shkresa nr. *** prot., datë *** me lëndë: *“Transferim/referim i çështjes në zbatim të pikës 2 të Vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit Agron Bushati”*, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

40. Në analizë të kriterit **“masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore”** në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor, rezulton se sjellja e magjistratit subjekt hetimi disiplinor mund të krijojë terren për sjellje të papërshtatshme edhe në rastet të tjera të ngjashme.

41. Në analizë të kriterit **“rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit”**, nuk ka të dhëna të kësaj natyre.

42. Ndërsa në analizë të kriterit **“sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit”** apo **“sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij”**, rezulton se sjellja e magjistratit ka qenë bashkëpunuese me paraqitjen parashtrimeve prej tij.

43. Referuar nenit 115, pika 1, shkronja “dh”; pika 2, shkronja “b”, pika 4, shkronja b) të Ligjit për Statusin, vlerësohet çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen dhe në rastin konkret mos-ekzistencën e ndonjë rrethane tjetër lehtësuese, por shkelja është e vazhdueshme për një periudhë të gjatë kohore.

44. Sipas Inspektorit, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore si një vonesë të rëndë dhe të pajustificuar në nxjerrjen e aktit procedural të urdhrin të ekzekutimit; (ii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit në formën e pakujdesisë; (iii) ekzistencën e rrethanës rënduese, pasi shkelja është vazhduese; (iv) vlerësimet profesionale të magjistratit emëruar si prokuror në vitin 2001, ku rezulton se ai ka 5 vlerësime të punës nga Prokurori i Përgjithshëm në vitet 2012 – 2016, ndër të cilat 2 vlerësime “mirë” dhe 3 vlerësimet e tjera “shumë mirë”. Për veprimtarinë e magjistratit Agron Bushati rezulton se pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë paraqitur ndaj tij 3 (tre) ankesa në të cilat janë ngritur pretendime për veprime/mosveprime apo vendimmarrje të padrejtë, 3 (tre) ankesa për zbatim të gabuar të ligjit procedural, të cilat janë arkivuar në vitin 2021, 2022 dhe 2023, ndërsa një ankesë ndodhet në fazë verifikimi lidhur me lirimin me kusht padrejtësisht të një të dënuari; (v) pasojat e ardhura në drejtim të të drejtave të të dënuarit dhe kohëzgjatjen e tyre; (vi) ekzistenca e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore, duke vlerësuar se përvoja e deritanishme e magjistratit në sistem nuk duhet të lejojë sjellje të kësaj natyre; (vii) mungesën e ndonjë arsyeje specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor, arrihet në konkluzionin se sjellja dhe veprimet e magjistratit Agron Bushati përbëjnë shkelje disiplinore

parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit për Statusin, që në rastin konkret përbëjnë “Shkelje të rëndë”.

45. Në analizë të çështjes lidhur me “**llojin e masës së disiplinore**” paraprakisht, vlerësohet se: Ligji për Statusin i referohet sanksionit disiplinor me termin “*masë disiplinore*”. Sipas parashikimeve të nenit 105 të ligjit, konstatohet se kjo dispozitë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji, parashikon detyrimin për përzgjedhjen e masave disiplinore të parashikuara nga kjo dispozitë në një liste prej 6 masash (*nga më e lehta te më e rënda*), me qëllim që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, në zbatim të parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizmit dhe proporcionalitetit.

46. Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit. Në të njëjtën kohë, masa disiplinore përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

47. Duke qenë se Ligji për Statusin ka përcaktuar se cilat veprime/mosveprime të magjistratit/prokuror përbëjnë shkelje disiplinore, por nuk parashikon se cilat shkelje janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda, për të arritur në këtë konkluzion në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore, duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, të parashikuara nga neni 115 i këtij ligji.

48. Për shkeljet e lehta disiplinore jepen si masa disiplinore vërejtja konfidenciale në rastin kur publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes ose vërejtja publike jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike. Kur shkelja është e rëndë ndaj magjistratit mund të jepet si masë disiplinore ulja në detyrë, dhe kur shkelja është shumë e rëndë masat e parashikuara nga ligji janë pezullimi ose shkarkimi nga detyra. Në rastin konkret, për rrethanat e shkeljes disiplinore masat më të lehta disiplinore do të ishin të papërshtatshme. Këto rrethana nuk përbëjnë shkelje disiplinore shumë të rëndë dhe nuk është e përshtatshme një masë disiplinore më e rëndë.

49. Sipas Inspektorit, për veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Agron Bushati, që përbëjnë shkelje disiplinore parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të Ligjit për Statusin, si masë disiplinore e përshtatshme e parashikuar nga neni 108, i Ligjit për Statusin, do të ishte “*Ulja e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në 1 vit*”, e cila jepet në këto raste: c) kur rrethanat e shkeljes nuk përbëjnë shkelje disiplinore shumë të rëndë dhe nuk është e përshtatshme një masë disiplinore më e rëndë.

50. Sipas Inspektorit, duke pasur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizmit dhe proporcionalitetit, pra, që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, vlerësohet se për veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Agron Bushati me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të cilat përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja "d", të Ligjit për Statusin, duhet të jepet masa disiplinore *"Ulja përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë deri në 1 vit"*, e parashikuar nga neni 108, e Ligjit për Statusin.

III. PARASHTRIMET E MAGJISTRATIT AGRON BUSHATI, INSPEKTORIT, QËNDRIMI DHE PROVAT E PARAQITURA PRA KËSHILLIT

51. Me Shkresën nr. 1114/5, datë 02.08.2024 "Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor dhe njohje me të drejtat", të Këshillit, magjistrati i janë njoftuar të drejtat e parashikuara në nenin 141, pika 2, të Ligjit për Statusin.

Njëkohësisht, magjistrati është ftuar të paraqesë parashitresa me shkrim para Këshillit, të paktën 1 (një) javë para datës së seancës dëgjimore, në zyrën e protokollit të Këshillit.

52. Nga verifikimi i bërë pranë zyrës së protokollit, si dhe në e-mail-in zyrtar rezulton, se në datë 11.09.2024, magjistrati Agron Bushati ka dërguar me e-mail **Parashitresat me Shkrim**. Në parashtrimet e tij, z. Bushati, ndër të tjera ka sqaruar:

"Në Shkodër, sot me datë 10.09.2024, unë Agron Bushati, Prokuror ne Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, pasi kam marrë dijeni në lidhje me Vendimin Nr. 178, datë 29.07.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj meje, po ju parashtoj qëndrimin tim, si më poshtë vijon :

Paraprakisht, dua të sqaroj se mbuloj Zyrën e Ekzekutimeve që prej vitit 2012 e në vazhdim. Gjatë gjithë këtyre viteve, kam përballuar i vetëm, të gjithë ngarkesën e këtij sektori.

*Në lidhje me rastin për të cilin është filluar procedimi disiplinor, theksoj se në asnjë moment, deri në datën që unë kam nxjerrë urdhrin përkatës të ekzekutimit për subjektin ***, nuk isha njohur dhe as nuk isha vënë në dijeni të vendimit penal të formës së prerë. Vendimi në fjalë, pas marrjes dijeni për problematikën, është tërhequr nga ana ime nga fashikulli i njohjes së vendimit penal të huaj për shtetasin ***, që ndodhej në Kryesekretari. Tërheqja e këtij vendimi dhe vënia në ekzekutim është bërë pa lënë gjurmë në ndonjë akt, pasi nisur nga fakti se nuk kisha marrë dijeni asnjëherë për këtë vendim, nuk kisha nënshkruar në asnjë vend për marrjen në administrim të tij, nuk më ishte kaluar në asnjë moment për ekzekutim, nuk kisha asnjë arsye të*

dyshoja që një situatë e tillë për të cilën nuk kisha asnjë lloj përgjegjësie, do të më kthehej në bumerang më vonë.

Vendimi në fjalë, gabimisht, nga *, nuk është vlerësuar drejt dhe nuk më është kaluar mua, si zakonisht, për vënien në ekzekutim të tij, sikurse çdo vendim tjetër i formës së prerë, por i ishte bashkangjitur fashikullit të njohjes së vendimit penal të huaj.**

Ky vendim i ka kaluar për dijeni vetëm prokurorit që ka përfaqësuar në atë kohë Prokurorinë në gjykim (pasi në atë periudhë rastet e marrëdhënieve juridiksionale me Jashtë nuk mbuloheshin nga Zyra e Ekzekutimeve, por nga prokurorë të ndryshëm që caktoheshin nga Drejtuesi, rast pas rasti). Pikërisht, ka qenë prokurori i çështjes, i cili konform ligjit, ka njoftuar Prokurorinë e Përgjithshme për finalizimin e njohjes së vendimit dhe në asnjë moment nuk më është kaluar edhe mua për dijeni dhe për efekt të vënies në ekzekutim, sikurse çdo vendim tjetër dënimi të formës së prerë.

Gjithashtu, dua të sqaroj se lidhur me rastin në fjalë, unë kam marrë dijeni rastësisht gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore me objekt « Lirimin para kohe me kusht », parashikuar nga neni 64 i K. Penal, për të dënuarin ***, (i cili ka rezultuar më pas se ishte vëllai i të dënuarit tjetër ***), i cili pas qëndrimit tim për rrëzimin e kësaj kërkesë, (qëndrim i cili është konsideruar i drejtë, mbështetur edhe nga Gjykata), pas përfundimit të gjyqimit, ka aluduar se qëndrimi im ishte i qëllimshëm dhe se unë mund të kisha ndonjë shkak për të cilin mbajta këtë qëndrim, sepse nuk kisha nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për vëllain e tij, subjektin ***. Pikërisht, ky ka qenë momenti që unë kam marrë dijeni për këtë fakt dhe jam vënë kryesisht menjëherë në lëvizje, duke verifikuar rastin në fjalë, praktikën e njohjes së vendimit të dënuarit ***, për të cilin nuk kisha marrë asnjëherë dijeni dhe kam kryer veprimet përkatëse dhe konkretisht lëshimin e urdhër ekzekutimit me shkresën përcjellëse Nr. ***, Prot/A.B, datë ***, dërguar I.E.V.P ***.

Sa më lart, dua të ritheksoj se nxjerrja me vonesë e këtij urdhër ekzekutimi për të dënuarin *, nuk ka ardhur në mënyrë kategorike si pasojë e neglizhencës, harresës apo shkak tjetër nga ana ime, por vetëm si pasojë e një gabimi administrativ të kryer nga ***, e cila në asnjë moment nuk më ka përcjellë për ekzekutim vendimin penal të formës së prerë.”**

53. Ndërsa, në seancën dëgjimore të mbajtur në datë 17.10.2024, ora 10.00, palët, përfaqësuesi i Inspektorit dhe magjistrati Agron Bushati paraqitën verbalisht qëndrimet e tyre, si dhe iu përgjigjën pyetjeve të anëtarëve.

54. Në mënyrë të përmblodhur magjistrati u shpreh, se: nga viti 2016 dhe në vazhdim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka pasur mungesa të ndjeshme të prokurorëve, madje ka pasur periudha kur ka pasur 5 apo 7 prokurorë në detyrë (për shkak të largimeve, transferimeve etj). Po ashtu, lëvizje të shpeshta ka pasur edhe në radhët e punonjësve të administratës. Këto lëvizje të personelit kanë shkaktuar vështirësi në funksionimin e prokurorisë dhe të sektorit të ekzekutimeve.

Pasi u pyet për faktet që rezultojnë në Procesverbalin e seancës gjyqësore të datës ***, në procesin gjyqësor me objekt llogaritjen e kohës së paraburgimit dhe përfitimin nga amnistia të kërkuarit ***, magjistrati mbajti qëndrimin, se: kur është vënë në dijeni të këtij fakti, nga *** i është thënë që vendimi është dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, ai shtoi se ka sqaruar gjyqtarin e çështjes, që ai nuk dispononte vendimin penal të formës së prerë dhe nuk e kishte të regjistruar te regjistri i tij.

Përfaqësuesi i Inspektorit, Julian Zonja u shpreh, se: në pretendimet përfundimtare i qëndron kërkesës fillestare të paraqitur pranë Këshilli, pasi shkelja qëndron dhe është konsumuar që me marrjen dijeni nga ana e magjistratit dhe në vazhdim, me mosekzekutimin e vendimit apo në mos nxjerrjen e një akti procedural ose zvarritjen e akteve procedurale që kanë sjellë pasoja, si dhe kërkesës tjetër për pranimin nga Këshilli, të masës disiplinore të uljes së pagës deri në 40 % për një periudhë një vjeçare.

55. Përveç sa parashtrohet në kërkesën e Inspektorit, z. Zonja, analizoi edhe provat e reja të administruara në zbatim të Vendimit nr. 204, datë 18.09.2024 “Për shtyrjen e seancës dëgjimore për marrjen e provave shtesë në procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit Agron Bushati”, të Këshillit.

Ai u shpreh, se : lidhur me sa është dërguar me Shkresën nr. 8595/1, datë 14.10.2024, “Dërgojmë informacion dhe akte”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër duhet të merret me rezervë nga ana e Këshillit, pasi është përgatitur dhe sigluar nga vetë magjistrati, subjekt procedimi disiplinor. Pavarësisht se në shkresë thuhet se nuk ka pasur libër të brendshëm dorëzimi dhe praktikat janë përcjellë në bazë të siglimit të Drejtuesit të Prokurorisë, siç ka funksionuar çdo prokurori në vend edhe Prokuroria Shkodër ka pasur libër dorëzimi që mbahet nga ***.

Përfaqësuesi i Inspektorit tha, se: edhe pse në këtë shkresë thuhet se vendimi i formës së prerë nuk i është komunikuar kundrejt nënshkrimit, magjistratit, ky i fundit ka ardhur në dijeni për mosekzekutimin e tij që në vitin ***. Magjistrati ka marrë pjesë në vitin 2018, kur ka marrë pjesë në dy gjykime: së pari, në gjykimin ndaj vëllait të ankuesit, shtetasit ***, pra ka zhvilluar gjithë procedurën e njohjes së tij dhe ka qenë në dijeni të situatës, sepse edhe në këtë gjykim i është bërë me dije, pasi ankesa për vonesë ka pasur edhe nga shtetasi ***. Së dyti, referuar Procesverbalit të seancës gjyqësore të datës ***, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimeve, në procesin gjyqësor me objekt llogaritjen e paraburgimit të shtetasit me kërkuar ankuesin ***, është kërkuar llogaritja e paraburgimit nga data ***, që është data e arrestimit të tij, deri në daljen e urdhrit të ekzekutimit, pra, që në objekt rezulton që nuk ka dalë urdhër ekzekutimi. Procesi gjyqësor në fjalë, ka filluar në datë *** dhe ka përfunduar më datë ***, me vendimin për shpalljen e moskompetencës. Në këtë gjykim janë ekspozuar prova, veçanërisht, Vendimi nr. ***, datë ***, i Gjykatës së Apelit, si dhe një shkresë

*e IEVP *** që ky institucion nuk ndërmerr asnjë veprim, pasi ankuesi *** mbahet me statusin e të paraburgosurit.*

*Sipas tij, faktet e mësipërme janë të qarta, që prokurori i ekzekutimeve ka marrë dijeni që nuk është ekzekutuar një vendim i formës së prerë. Referuar Procesverbalit të seancës gjyqësore të datës *** në prani të prokurorit, ankuesit *** dhe avokatit, gjyqtari i çështjes ka bërë me dije se ka një periudhë prej 1 vit e 4-5 muaj që vendimi ka marrë formë të prerë. Ka pasur dhe diskutime të tjera, që nuk ka urdhër ekzekutimi, që janë bërë shumë kërkesa, që është bërë kërkesë Avokatit të Popullit dhe dijenia e magjistratit është më se e provuar. Referuar, nenit 22, të Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar, vendimet, me marrjen formë të prerë me burgim, i dërgohen prokurorit nga gjykata menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim. Në funksionet e tjera të prokurorit të ekzekutimeve, parashikohet edhe kontrolli i zbatimit të vendimeve të formës së prerë.*

*Si përfundim, përfaqësuesi i Inspektorit pohoi, se: të paktën që nga viti ***, magjistrati ka ardhur në dijeni të kësaj problematike, të mos ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Nga kjo periudhë deri në vitin *** kur është lëshuar urdhëri i ekzekutimit, është periudhë relativisht e gjatë. Pasojat që ka sjellë ky veprim, kanë cenuar të drejtat e të dënuarit ***. Qoftë me ligjin e mësipërm, por edhe me Ligjin në fuqi (Nr. 79/2020), prokurori ka për detyrë të rivendosë ligjin dhe të drejtat e cenuara, si një nga detyrat kryesore.*

Përfundimisht, sipas përfaqësuesit të Inspektorit, shkelja disiplinore qëndron, shkak për të cilin është propozuar edhe masa disiplinore.

*56. Më pas, magjistrati u shpreh, se: për përgatitjen e përgjigjes për Inspektorin, sipas Shkresës nr. ***, datë ***, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është angazhuar ai dhe magjistratja tjetër që njihte çështjen. Materiali përfundimtar i është dërguar Drejtuesit të Prokurorisë, i cili e ka korrigjuar duke e konceptuar ndryshe nga ajo që ishte nisur. Për shkak të eksperiencës 32 vjeçare në punë, do të ishte shumë dritëshkurtër sikur të vinte pa dashje siglimin e tij në atë shkresë, siglim i cili ka qenë dashamirës dhe pa asnjë qëllim tjetër. Magjistrati ka kërkuar që në këtë çështje të mos përfshihen persona të tjerë, siç është Drejtuesi i Prokurorisë. Në përfundim, ka kërkuar që të merren parasysh edhe momentin dhe rrethanat e vështira të punës në atë periudhë, ku barra kryesore e saj ka rënë mbi magjistratin.*

57. Përveç Parashtrimeve me shkrim të paraqitura më datë 11.09.2024, dërguar me e-mail nga prokurori Agron Bushati përpara seancës dëgjimore, ai nuk ka paraqitur prova dokumentare shtesë.

IV. VEPRIMET PROCEDURALE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

58. Këshilli dhe Komisioni Disiplinor ka kryer veprimet procedurale në lidhje me kërkesën e ardhur nga Inspektori për marrjen e masës disiplinore “*“Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në një vit”*” ndaj prokurorit Agron Bushati, si më poshtë:

- i. Në datë 25.07.2024, ora 10.45, Komisioni Disiplinor ka zhvilluar mbledhjen për hedhjen e shortit për caktimin e Relatorit.
- ii. Nga ana e Relatorit u bë verifikimi i përmbushjes së kriterëve formale të kësaj kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, duke vijuar me procedurat e tjera sipas neneve 24 dhe 25, të Rregullores së Disiplinës.
- iii. Po në datë 25.07.2024, Komisioni Disiplinor ka miratuar Relacionin “*Për caktimin e datës së seancës dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit Agron Bushati*”, të shoqëruar nga projektvendimi përkatës. Për shkak të përkimit të afatit të procedimit disiplinor me periudhën e pushimeve vjetore të magjistratit (neni 23, i Ligjit për Statusin), Komisioni Disiplinor ka vlerësuar të nevojshme shtyrjen e afatit për caktimin e seancës dëgjimore me 1 (një) muaj, nga afati i parashikuar në nenin 138, pika 2, shkronja “a”, i Ligjit për Statusin. Komisioni Disiplinor ka propozuar, që seanca dëgjimore për prokurorin Agron Bushati të zhvillohet në **dt. 18.09.2024, ora 10.00**, në përputhje me nenin 138, pika 3, të Ligjit për Statusin.
- iv. Propozimi i Komisionit Disiplinor për zhvillimin e seancës dëgjimore në **dt. 18.09.2024, ora 10.00** është miratuar me Vendimin nr. 178, datë 29.07.2024 “Për caktimin e seancës dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit Agron Bushati”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- v. Me Shkresën nr. 1952/2, datë 01.08.2024 “*Dërgohet Vendimi nr. 178, datë 29.07.2024, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë*”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurori Agron Bushati dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë janë njoftuar për datën e seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 141, të Ligjit për Statusin.
- vi. Me Shkresën nr. 1114/5, datë 02.08.2024 “*Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor dhe njohje me të drejtat*”, prokurori Agron Bushati është njohur me fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij, si dhe me të drejtat e tij në këtë proces, në përputhje me nenin 141, pika 2, të Ligjit për Statusin. Njëkohësisht, ai është njoftuar lidhur me të drejtën për të paraqitur parashtresa me shkrim para Këshillit, të paktën një javë përpara datës së seancës dëgjimore.
- vii. Më datë 11.09.2024 janë administruar Parashtresat me Shkrim të prokurorit Agron Bushati, të dërguara me e-mail.
- viii. Në datë 11.09.2024, ora 13.30, u zhvillua mbledhja e Komisionit Disiplinor për të shqyrtuar dhe diskutuar Relacionin Paraprak të përgatitur nga Relatori i çështjes z. Zeqir Hoda dhe në përfundim të mbledhjes, pas miratimit nga Komisioni, **Relacioni paraprak** i miratuar i është vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit, për t’u njohur para seancës dëgjimore.
- ix. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datë **18.09.2024, ora 10.00**, në prani të magjistratit Agron Bushati dhe përfaqësuesit të Inspektorit, z. Julian Zonja, me qëllim sqarimin e plotë

të faktorëve dhe rrethanave që kanë rëndësi për këtë procedim disiplinor, me Vendimin nr. 204, datë 18.09.2024 *“Për shtyrjen e seancës dëgjimore për marrjen e provave shitesë në procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit Agron Bushati”*, është vendosur shtyrja e seancës dëgjimore dhe Inspektori është ngarkuar të kryejë verifikime të mëtejshme dhe të administrojë aktet përkatëse. Ky vendim i është dërguar Inspektorit, me shkresën nr. 1114/10, datë 18.09.2024 *“Njoftohet vendimi nr. 204, datë 18.09.2024, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, drejtuar Inspektorit. Njëkohësisht, me shtyrjen e seancës dëgjimore, Këshilli ka caktuar zhvillimin e seancës së ardhshme dëgjimore në dt. 17.10.2024, ora 10.00.

- x. Në datë 17.10.2024, ora 10.00 është zhvilluar seanca tjetër dëgjimore, në prani të magjistratit Agron Bushati dhe përfaqësuesit të Inspektorit, z. Julian Zonja.
- xi. Inspektori ka dërguar Shkresën nr. 254/52, datë 16.10.2024, *“Dërgojmë informacion dhe aktet përkatëse”*, shoqëruar nga Shkresa nr. 8595/1, datë 14.10.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Shkresa nr. 1194/3, datë 11.10.2024 *“Kthim përgjigje”*, e Prokurorisë së Përgjithshme, e-mail datë 15.10.2024 (regjistruar me nr. 254/50, datë 15.10.2024 të ILD), si dhe Shkresë nr. 1738/1, datë 14.10.2024 *“Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 254/46 prot., datë 07.10.2024”* të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Këto akte janë të paraqitura nga ana e Inspektorit një orë para zhvillimit të seancës dëgjimore datë 17.10.2024.
- xii. Gjatë seancës dëgjimore, magjistrati Agron Bushati dhe përfaqësuesi i Inspektorit z. Julian Zonja parashtruan verbalisht qëndrimet e tyre dhe konkluzionet përfundimtare.
- xiii. Në përfundim të seancës dëgjimore, pas administrimit të Shkresës nr. 254/52, datë 16.10.2024 *“Dërgojmë informacion dhe aktet përkatëse”* dhe dokumentacionit shoqërues, të Inspektorit (cituuar më sipër), Këshilli vendosi shpalljen e vendimit për këtë procedim disiplinor, në datë 29.10.2024, ora 10.00.
- xiv. Në datë 23.10.2024, ora 09.00 u zhvillua mbledhja e Komisionit Disiplinor për miratimin e **Relacionit përfundimtar Nr. 1114/12, datë 23.10.2024**, të këtij procedimi disiplinor. Sipas këtij Relacioni:
 - 2 (dy) anëtarë të Komisionit Disiplinor kanë mbajtur qëndrimin, se propozimi i masës disiplinore **“Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në një vit”**, e parashikuar nga neni 108, i Ligjit për Statusin, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të këtij Ligji i Inspektorit ndaj magjistratit Agron Bushati, **duhet pranuar në masën “Ulje e përkohshme e pagës 20 % për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”**.
 - anëtari tjetër i Komisionit Disiplinor mbajti qëndrimin, se propozimi i masës disiplinore **“Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në një vit”**, e parashikuar nga neni 108, i Ligjit për Statusin, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të këtij Ligji, i Inspektorit ndaj magjistratit Agron Bushati, **duhet rrëzuar plotësisht**.

V. VLERËSIMET DHE KONKLUZIONET E KËSHILLIT

59. Lidhur me shkeljen disiplinore të pretenduar të magjistratit Agron Bushati, duke pasur parasysh rrethanat e mëposhtme, **shumica e anëtarëve të Këshillit ka mbajtur këtë qëndrim:**

➤ **Mungesa e qëllimit për të dëmtuar palët ose procesin ligjor.**

Në analizën e kualifikimit të shkeljeve disiplinore, Ligji për Statusin kërkon që **qëllimi dhe pasojat e drejtpërdrejta** të veprimeve të jenë faktorë përcaktues për klasifikimin e shkeljes. Duke qenë se magjistrati Agron Bushati nuk ka shfaqur qëllim të qartë për të ndikuar negativisht mbi të drejtat e ankuesit ***, si dhe situata ka ardhur si pasojë e mangësive organizative, shkelja nuk duhet klasifikuar si e rëndë. Mungesa e qëllimit të keq mund të interpretohet si faktor që i jep shkeljes karakter **të lehtë dhe jo të rëndë**, duke marrë parasysh se dështimi nuk është produkt i neglizhencës apo i papërgjegjshmërisë flagrante të magjistratit.

➤ **Rrethanat objektive dhe të jashtme që ndikuan në shkeljen disiplinore.**

Shkeljet e rënda shpesh karakterizohen nga veprime ose mosveprime, që janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të magjistratit. Në këtë rast, **mungesa e burimeve mbështetëse**, përfshirë personelin e mjaftueshëm për trajtimin e rasteve të ekzekutimeve dhe deficitet në komunikimin institucional, janë rrethana objektive që kanë ndikuar në kryerjen e shkeljes. Këto rrethana, jashtë kontrollit të magjistratit e bëjnë të arsyeshme që shkelja të trajtohet si e lehtë, pasi magjistrati nuk ka pasur aftësinë e plotë për të përmbushur të gjitha kërkesat e detyrës.

➤ **Përgjegjësia e Sekretarisë së Prokurorisë për përcjelljen e dokumenteve.**

Në arsyetimin e magjistratit, theksohet se dokumenti për vendimin penal nuk i është dorëzuar, çka ka çuar në vonesën e ekzekutimit. Duke pasur parasysh se përgjegjësia për shpërndarjen e dokumenteve është e organizuar sipas një protokollit të veçantë, mendoj që **vonesa nuk është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e magjistratit**, por një problem organizativ. Ndëshkimi mund të përfshijë rekomandime për përmirësime organizative dhe komunikime të brendshme në prokurori, pa aplikuar një ndëshkim të rëndë mbi magjistratin për këtë rast.

➤ **Vonesa e paqëllimshme, si rezultat i pamundësisë për administrimin në kohë të vendimeve gjyqësore.**

Një vonesë, që vjen si pasojë e **pamundësisë për administrimin në kohë të vendimeve**, për shkak të mangësive në burimet e zyrës apo mungesës së njoftimit të plotë dhe të duhur për vendimin, mund të konsiderohet një shkelje e lehtë. Kur shkelja është rezultat i një faktori që nuk lidhet drejtpërdrejt me vullnetin ose neglizhencën e magjistratit, por me situatën specifike të detyrës dhe ngarkesën administrative, ajo duhet të klasifikohet më e lehtë se zakonisht.

➤ **Pasojat e shkeljes nuk ishin të paramenduara dhe mund të rregulloheshin në kohë.**

Në raport me pasojat, rëndësia e shkeljes varet gjithashtu nga **ndikimi aktual dhe i qëndrueshëm** i saj mbi palët e përfshira. Në këtë rast, pavarësisht vonesës, ekzekutimi mund të kryhej sapo magjistrati u informua për vendimin përkatës, duke sugjeruar se shkelja ishte e korrigjueshme dhe

se pasojat nuk ishin të pakthyeshme. Një pasojë e tillë korrigjueshme dhe e përkohshme, nuk e përmbush kriterin për t'u konsideruar si shkelje e rëndë, për shkak se ndikimi ishte i limituar dhe nuk kishte qëllim dëmtues apo ndikim të përhershëm mbi të drejtat e të dënuarit.

➤ **Përvoja profesionale dhe kontributi i magjistratit.**

Rekordi i gjatë i magjistratit, pa precedentë të mëparshëm të shkeljeve të rënda dhe me vlerësime pozitive për përkushtimin dhe përmbushjen e detyrave, sugjeron që shkelja nuk duhet të trajtohet si e rëndë, për të mos kompromentuar imazhin e një magjistrati me karrierë të respektuar. Ligji parashikon, që kur vlerësimet e mëparshme të një magjistrati tregojnë për një qëndrim përgjegjës dhe korrekt në përgjithësi, ky aspekt mund të përdoret për të klasifikuar shkeljen si të lehtë. Një interpretim i tillë mund të përdoret për të argumentuar se shkelja ishte rastësore dhe nuk përfaqëson një model sjelljeje të vazhdueshëm.

➤ **Proporcionaliteti në marrjen e vendimeve disiplinore për shkeljet e karakterit procedural.**

Vonesa në nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, nëse nuk ka sjellë dëme serioze për palët, duhet të konsiderohet një **shkelje më shumë procedurale sesa thelbësore**, çka justifikon klasifikimin si shkelje të lehtë. Duke pasur parasysh se nuk ka ndikuar mbi drejtësinë e vendimit penal në vetvete, kjo shkelje procedurale mund të interpretohet si e lehtë dhe jo si e rëndë, duke konsideruar nevojën për proporcionalitet në ndëshkimin e shkeljeve që kanë karakter procedural.

60. Duke përdorur këto argumente, shumica e anëtarëve të Këshillit vlerësojnë, se: ndodhen para rivlerësimit të sjelljes së magjistratit që e klasifikon shkeljen nga e rëndë në të lehtë, duke e bazuar në rrethana lehtësuese dhe duke e prezantuar vonesën si pasojë të kushteve të jashtme dhe jo si veprim të qëllimshëm ose të papërgjegjshëm.

61. Në vlerësimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit, masa disiplinore "Vërejtje publike", parashikuar nga nenet 105, shkronja "b" dhe 107, të Ligjit për Statusin, ndaj magjistratit Agron Bushati do të ishte një masë e ekuilibruar dhe edukative, që adreson shkeljen në mënyrë proporcionale dhe inkurajon përmirësimet e nevojshme në procedurat e Zyrës së Prokurorisë ku ushtron detyrën magjistrati, pa qenë e ashpër dhe e panevojshme në ndikimin mbi karrierën e tij. Kjo masë reflekton një qasje konstruktive ndaj shkeljes dhe ndihmon në ruajtjen e një ekuilibri mes mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe realiteteve të punës së magjistratëve, duke gjetur mbështetje, gjithashtu nga neni 101, pika 2, shkronja "d", e Ligjit për Statusin., i cili parashikon se:

"2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshtësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;

c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;

ç) dëmtimi, mundësia e shkakut të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe

d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.”

62. Në këtë mënyrë, vendimi për caktimin e masës disiplinore mund të synojë më shumë në masat për të përmirësuar proceset administrative dhe organizative të prokurorisë, sesa në një ndëshkim të rëndë për magjistratin, duke mos rënduar drejtpërdrejt magjistratin në fjalë, për një situatë që ka ndikuar dhe është jashtë kontrollit të tij të drejtpërdrejtë.

63. Për rrjedhojë, shumica e anëtarëve të Këshillit janë të mendimit, se ndaj magjistratit Agron Bushati duhet të jepet masa disiplinore “Vërejtje publike”, parashikuar nga nenet 105, shkronja “b” dhe 107, të Ligjit për Statusin.

64. Në lidhje me të drejtën e ankimit Këshilli vëren, se neni 148/d i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “... 3. *Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.*” Në nenin 147, të Ligjit për Statusin përcaktohet e drejta e ankimit ndaj vendimeve që përmbajnë masa disiplinore. Sipas këtij neni, magjistrati dhe Inspektori kanë të drejtë të ankimojnë vendimin për caktimin e masës disiplinore në gjykatën kompetente.

Ndërsa, në nenin 192, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar parashikohet se: “1. *Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese...*”

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 148/d, pika 1 dhe 149/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 102, pika 1, shkronja “d”, 105, pika 1, shkronja “b”, 107, 115 dhe 146, pika 2, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, shkronja “a” dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dhënien e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë deri në një vit”, e parashikuar nga neni 108, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1,

shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Caktimin e masës disiplinore “*Vërejtje publike*”, për magistratin Agron Bushati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magistratit Agron Bushati, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4, i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Zeqir Hoda

(kundër)

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Vatë Staka

(kundër)

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Erind Gërmenji

(kundër)

ANËTAR

Erind Merkuri

ANËTAR

Erion Fejzulla